

që t'u mësojnë të vërtetat e Zotit koreano-veri-orëve në Kinë dhe në vende të tjera.

25. Shumicën e koreanëve të veriut, të cilët janë të uritur dhe kanë pak liri. Lutuni që Perëndia do t'i shpëtojë fëmijët e tij nga këto rrethana të tmerrshme. "Pastaj Zoti tha: "Sigurisht që e kam parë pikëllimin e popullit tim që ndodhet në Egjipt dhe e kam dëgjuar britmën e tij për shkak të shtypësve të tij, sepse i njoh vuajtjet e tij." (Eksodi 3:7).

26. Të krishterët në Azinë verilindore për të kapërcyer tundimet, për të jetuar jetë të pastër dhe për të shpallur ungjillin dhe për të transformuar shoqëritë e tyre. "Ju jeni drita e botës. ... Ashtu le të shndritë drita juaj para njerëzve, që të shohin veprat tuaja të mira dhe ta lëvdojnë Atin tuaj që është në qiej." (Mateu 5:14,16).

27. Udhëheqësit e vendeve në Azinë verilindore, ndërsa përgatiten për konflikte të mundshme në rajon. Kina tashmë po ndërton një rrjet kampesh refugjatësh përgjatë kufirit me Korenë e Veriut.

28. Mbrojtje kundër ngacmimit seksual për gratë në vendin e punës. Lutuni që njerëzit e Perëndisë të qëndrojnë të palëkundur në besimin e tyre dhe të kenë guximin të ngrihen në këmbë për gratë që abuzohen.

29. Vajzat e reja dhe adoleshentet në Kamboxhia, Laos, Myanmar dhe Vietnam, të cilat janë në rrezik të shiten tek burrat kinezë si "gra" sepse në zonat rurale ka shumë pak femra.

30. Për të gjithë ata, që ende nuk e kanë dëgjuar mesazhin e hirit të Perëndisë. Nëpërmjet lutjes, shpallni për Perëndinë gratë, burrat dhe fëmijët nga çdo komb, fis, popull dhe gjuhë të cilët do të përkulen përpara Zotit dhe ta pranojnë atë si Zot.

31. Gratë kineze dhe koreane në Kinë, Hong Kong, Tajvan, Korenë Veriore dhe Jugore, dhe në mbarë botën. Kërkoni në lutje që ato të drejtohen për t'u lutur për njëra-tjetrën dhe për të ndihmuar gratë që vuajnë dhe kanë nevojë të përjetojnë dashurinë e Perëndisë.

Gratë në vendet aziatike verilindore të Kinës, Japonisë, Koresë së Veriut dhe Koresë së Jugut jetojnë jetë që ndryshojnë në mënyrë dramatike nga njëra-tjetra.

Lëvizja globale e lutjes "TWR Shpresë për ty" dhe media përpiqen të adresojnë situatat e tyre unike. Gratë në Kinë përballen me sfida të mëdha, shumica e të cilave vijnë nga pikëpamja tradicionale se gratë janë më pak të vlefshme se burrat. Kina është vendi i vetëm në të cilin vetëvrasjet në mesin e grave i tejkalojnë ato në mesin e burrave. Politika e planifikimit familjar të Kinës "një familje një fëmijë" që prej 1979-2015 ka sjellë me miliona aborte traumatike të detyruara. Mjerisht, shumë familje këmbëngulën që gratë e tyre shtatzëna të abortonin foshnjat vajza për të siguruar që do të lindnin vetëm djem të çmuar. Politika dy-fëmijë që filloi në 2015 ka rezultuar në një rritje të numrit të lindjeve.

Megjithatë, sot për shkak të miliona bebeve vajza që nuk kanë lindur ndonjëherë, vendi përpiqet të kapërcejë sfidat që rezultojnë nga një mospërputhje midis numrit më të ulët të grave që janë në moshë për të lindur fëmijë dhe rreth 33 milionë burrave që nuk mund të gjejnë nuse.

Në Korenë e Veriut, njerëzit vazhdojnë të kenë ushqim, ujë dhe higjenë të kufizuar. Rreth 18 milionë, ose 70 për qind e popullsisë, vuajnë nga kequshqyerja dhe luftojnë me çështjet shëndetësore të paplotësuar. Disa gra të dëshpëruara rrezikojnë gjithçka duke u përpjekur të arratisen nga vendi dhe shpesh janë të detyruara të punojnë në shtëpitë publike ose të bëhen "nuset" e burrave në Kinë. Nëse kapen nga autoritetet në Kinë, shumë prej tyre kthehen në Korenë e Veriut, ku përballen me tortura në kampet e punës ose ekzekutohen.

Koreja e Jugut tani është shtëpia e më shumë se 30,000 të larguarve të Koresë së Veriut, duke përfshirë rreth 16,000 gra që udhëtuan përmes Kinës, Vietnamit dhe Mongolisë për të fituar lirinë. Skuadra e TWR Shpresë për ty dëshiron t'i ndihmojë t'i drejtojnë ato tek Zoti ynë Jezhu Krisht.



Të lutemi për gratë në Azinë Verilindore



Dëgjoni kalendarin e lutjes online në twr-albania.com

Dëgjoni programin "Shprese per ty" në:

Radio 7: 97,7 FM: të shtunën ora 8:30

Radio Emanuel: 95,7 FM të shtunë ora 9:00

Radio Logos: 94,2 FM të shtunë/ të dielë ora 9:00 dhe 17:00

Të lutemi për...

1. Të krishterët në Azinë verilindore që të jetojnë në një mënyrë që e nderon Perëndinë, duke kultivuar një pamje të jashtme që pasqyron vlerat e mësuar në Fjalën e Perëndisë. “Por vishuni me Zotin Jezu Krisht dhe mos tregoni kujdes për mishin, që t’ia kënaqni lakmitë.” (Romakëve 13:14).

2. Gratë e krishtera në mbarë globin që po luten së bashku në ditën botërore të lutjes në 170 vende.

3. Gratë që të vazhdojnë të qëndrojnë të palëkundura në të vërtetën e Perëndisë pavarësisht nga vuajtjet për shkak të besimit të tyre të krishterë ose përballjes me kundërshtimin e burrave të tyre jobesimtarë.

4. Drejtimin e Perëndisë dhe për forcë fizike për ekipin e prodhimit të programeve “Shpresë Për ty” në gjuhën Mandarin. Lutuni që dëgjuesit e programeve në radio me valë të shkurtra ose në internet do t’i përgjigjen thirrjes së Krishtit për shpëtim.

5. Gratë në 36 grupe lutjesh në Kinë, Hong Kong, Singapor dhe Tajvan të cilat lexojnë përkthimin kinez të kërkesave për lutje dhe pastaj luten në gjuhët e tyre të zemrës dhe në dialektet e tyre.

6. Mbrojtjen e Perëndisë për gratë kineze në shërbesa ndërsa ndajnë të vërtetat e Perëndisë. Lutuni që Perëndia do t’i bekojë me shëndet të mirë, me zemër të gëzuar dhe do të sigurojë gjërat e nevojshme. Lutuni që ato të marrin kujdesje dhe të respektohen nga anëtarët e kishës së tyre.

7. Gratë në Kinë, të cilat janë të detyruara t’i nënshtrohen operacioneve për të hequr aftësinë e tyre për të riprodhuar. Lutuni gjithashtu për gratë që kanë duruar gjopa të mëdha, abuzime fizike ose burgim, sepse nuk i kanë abortuar foshnjat e tyre.

8. Presionin, që ushrohet mbi familjet në Kinë, ku shumica e të rriturve nuk kanë vëllezër, motra, halla ose xhaxhallarë. Shpesh, çiftet duhet të kujdesen për katër prindër të moshuar. Shumë çifte të rinj po zgjedhin të mos kenë fëmijë për arsye financiare.

9. Që më shumë vajza në Kinë të kenë mundësi të studiojnë. Shumë prindër ende besojnë se arsimimi për vajzat është një humbje kohe dhe parash. Si rezultat, shumë gra nuk janë në gjendje të fitojnë punë të mira për shkak të mungesës së aftësive dhe njohurive të tyre.

10. Gratë e minoriteteve në Kinë që të kenë mundësi të dëgjojnë programet e grave në gjuhën e tyre të zemrës dhe në një mënyrë që flet për nevojat e tyre.

11. Gratë kineze që po konsiderojnë vetëvrasje. Numri i vetëvrasjeve midis femrave në Kinë është më i larti në botë (rreth 590 në ditë). Lutuni që nëpërmjet programeve “Shpresë për ty” këto gra do të dëgjojnë mesazhin e shpresës në Krisht dhe do të fillojnë të ndiejnë vlerën e tyre te Perëndia, Krijuesi i tyre.

12. Ndërhyrjen dhe mbrojtjen e Zotit për gratë në Kinë, që përballen me dhunimin, rrëmbimin dhe skllavërinë. Për shkak të mungesës së grave, shumë vajza të huaja dhe nga zonat rurale shiten në “martesa” kundër vullnetit të tyre dhe ndonjëherë ndahen midis vëllezërve.

13. Prindërit kinezë dhe koreanë për të vlerësuar jetët e vajzave, duke kuptuar se ato janë një dhuratë e Perëndisë. Aborti po përdoret si një mjet për kontrollin e lindjeve pa u kujdesur fare për jetën që po shkatërrohet. Shumë gra të reja dhe beqare kanë bërë disa aborte dhe nuk kanë dëgjuar për rreziqet që kjo ka për shëndetin e tyre.

14. Kina të ndalojë deportimin e të krishterëve të Koresë së Jugut, të cilët po përpiqen të ndihmojnë njëri-zit që duan të shpëtojnë nga uria në Korenë e Veriut.

15. Gratë e vetme që i shërbejnë Zotit dhe kanë nevojë për ngushëllim dhe inkurajim kur përballen me vështirësi pa mbështetjen e burrave apo familjeve.

16. Nënata e krishtera të bëhen modele të mira me anë të fuqisë së Frymës së Shenjtë. Lutuni që ato ta duan Fjalën e Perëndisë, të çmojnë mundësinë në kishë për të adhuruar dhe për të mësuar, për t’i shërbyer Perëndisë dhe të tjerëve dhe të përpiqen të ecin ngushtë me Perëndinë. “por unë kam ardhur që të kenë jetë e ta kenë me bollëk (Gjoni 10:10b).

17. Ekipin Korean të prodhimit dhe përkthimit të programit “Shpresë për ty” e përbërë prej 30 vullnetarësh, i cili po ofron shpresë dhe inkurajim për gratë në Korenë e Veriut. Ata nuk marrin asnjë përgjigje nga ky vend i izoluar, ku gratë e krishtera përballen me abuzime të tmerrshme.

18. Vullnetarët që u shpërndajnë të huajve në Korenë e Jugut kalendaret e lutjes në gjuhët kamboxhiane, kineze, indoneziane, japoneze, tagaloge, thai dhe vietnameze. Lutuni që më shumë njerëz të bashkohen me lëvizjen e lutjes nëpërmjet këtyre grupeve të emigrantëve në Korenë e Jugut.

19. Më shumë mundësi për të preazantuar shërbesën “TWR Shpresë për ty” tek pastorët dhe grupet e kishave në Korenë e Jugut dhe më gjërë.

20. Gratë koreane që jetojnë në vende të tjera të botës për të formuar grupet e lutjes që do të mbështesin përpjekjet për të arritur më shumë gra përmes programeve koreane “Shpresë për ty”. Programet gjithashtu mund të dëgjojnë në internet në TWR 360.

21. Kishën nëntokësore në Korenë e Veriut, që Perëndia t’i japë forcë, këmbëngulje dhe besim të përtërirë çdo ditë për të kapërcyer përndjekjen dhe vështirësitë.

22. Siguri për organizatat e shërbesës që shpërndajnë radio, Bibla dhe të tjera gjëra lehtësuese për koreano-veriorët. “Le të mos lodhemi duke bërë të mirën; sepse, po të mos lodhemi, do të korrim në kohën e vet. Prandaj, sa të kemi rast, le t’u bëjmë të mirën të gjithëve, por në radhë të parë atyre që janë në familjen e besimit.” (Galatasve 6: 9-10).

23. Ata që largohen me dëshpërim nga Koreja e Veriut dhe kalojnë përmes Kinës, Vietnamit dhe Mongolisë për të arritur përfundimisht në Korenë e Jugut. Koreja e Jugut tani është shtëpia e më shumë se 30,000 të larguarëve, duke përfshirë rreth 16,000 gra. Ata i merr malli thellësisht familjet e tyre në Korenë e Veriut dhe luftojnë për të gjetur punë.

24. Mbrojtje për koreano-veriorët që hyjnë në Kinë në mënyrë të paligjshme për t’i shpëtuar urisë dhe shpesh janë të detyruara të punojnë në shtëpitë publike ose të martohen me burra kinezë. Lutuni për të krishterët e Koresë së Jugut